

# KËNGËT E PARA



*Vjersha*

BIBLIOTEKA E RINISË

SHH-1  
K 51

BIBLIOTEKA E RINISË

# KËNGËT E PARA

(Antologji me vjersha të nxënësve)

~~4088L~~ 13044

BIBLIOTEKA E SHTRIT,  
GJIRËVËSIT

SHTRITIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

## TË DASHUR LEXUES!

Libri që po merrni në duar, përmban vjersha, që i kanë shkruar nxënës të shkollave 12-vjeçare.

Duke lexuar këto vjersha, ju do të gjeni në to veten tuaj, me ato përpyekje që ju shpesh bëni në orët e hartimit apo gjatë studimit, për të shprehur ndjenjat tuaja të pastra, të zjarrta rinore.

Autorët e rinj janë nxënës nga qytetet Durrës, Elbasan, Berat e ndonjë nga qyteti Stalin. Ata kanë shprehur në vjershat e tyre, si kanë mundur më bukur, dashurinë për Partinë tonë heroike që e udhëhoqi popullin nga fitorja në fitore, për udhëheqësin e saj, shokun Enver, për heroin legjendar Skënderbe. Shumë prej tyre janë frymëzuar nga bukuritë e atdheut tonë, nga heroizmi i partizanëve, nga vdekja heroike e Adem Rekës etj. Dashuria për nënën, puna e rinisë në aksionet e saj, janë gjithashtu tema të vjershave të këtij vëllimi.

Eshtë libri i parë i këtij lloji që po boton Shtëpia Botonjëse «Naim Frashëri». Po ajo do ta vazhdojë këtë punë duke botuar edhe vëllime të tjera me tregime e hartime të bukura apo edhe me vjersha e poema shkruar nga nxënësit. Ju vetë mund të mblidhni në qytetin tuaj, në shkollën o klasën tuaj shkrimet më të bukura ashtu si kanë bërë edhe nxënësit e qyteteve Durrës, Elbasan dhe Berat.

## TI, PARTI!

Ti linde  
atë Nëndor  
Mbrenda  
mureve  
të vjetër  
të një shtëpie  
Dhe dole  
prej saj;  
u rrite.  
Dole prej saj  
dhe more  
rrugën drejt idealit,  
Dole prej saj  
me flamurin  
e revolucionit,  
Dhe e  
valëvite,  
e ngrite lart,  
lart!  
Retë, errësira  
u çanë  
prej tij,  
nga drita jote,  
Parti!

... Bajonetat,  
zjarri  
u ngritën  
të të ndalin,  
Por kurrë,  
jo,  
s'të ndalën.  
Tallazeve  
armike  
dhe zjarrit  
të luftës  
kalove;  
s'u ndale,  
u kalite.  
Thirre,  
popullin, forcën  
e pashtershme,  
forcën  
që buron  
nga gjokset e etur  
për liri.  
Populli u ngrit;  
të ndoqi pas,  
Drejt shtegëtimit  
ndër betejat për liri.  
... Pishtar i  
luftës,  
busullë  
e së vërtetës,  
Ece, me  
popullin përkrah,  
dhe duart  
U ngritën,  
u bënë një,

Se ideali  
ishte një,

Se flamuri  
ishte  
një,

Se liria  
ishte  
një.

Ti, Parti, çon gjithmonë drejt qëllimit  
të ideve të mëdha,

drejt Socializmit.

Populli  
Marshon,  
përsëri  
marshon.

Marshon,  
ndërton, mbron.

Maleve  
ndihet puna;  
kazma ndihet,

e bashkë  
me të dhe  
shekullorja

pushkë pranë.

Fushës —  
punë,  
vrull, vetmohim.

Uzinave — punë,  
vrull, vetmohim.

Fushave,  
uzinave,

kazma, pushka,  
njerëz të rinj.

«NE...»

Po!  
Ne jemi,  
Do të jemi  
Rinia që mëson,  
mbron,

edukohet.  
Socializmi është'  
synimi

ynë,  
Ne  
mësojmë,  
kalitemi  
mbrojmë

atdheun,  
fitoret,  
socializmin

Ne jemi  
e ardhmja, forca,  
e reja.

Ne  
Partinë  
sigurojmë.

Atje, maleve,  
kodrave

Do të  
«qepemi»

Dhe...  
Forca, vrulli,  
e reja

Kudo,  
në male,  
bjeshkë,

Atje  
do ndihet.

Atje  
ku zër' i Partisë,  
Atdheut,  
Socializmit

na thërret.

Atje  
me idealin  
gjithçka për

shoqërinë e  
re.

**Pandeli Theodhori**  
(Shkolla «Naim Frashëri», Durrës)



## **THJESHT**

Në këngët e popullit Ai shkruhet thjesht:  
**ENVER.**

Në këngët tona prapë thjesht Ai:  
**ENVER.**

Ne ecim më shpejt se vrapi i viteve,  
dhe në ballin e tyre shkruajmë thjesht:  
**ENVER.**

Heroizmat ngjasin,  
Heroizmat flasin.

Për heronjtë këndohet,  
Për heronjtë tregohet.

Ndaj, në faqet e historisë shqiptare  
do të shkruhet

e **THJESHTA**, po dhe aq e shtrenjta fjalë,  
**ENVER,**

## SÛLMUESIT

Parakalojnë në kujtesën tonë rrjeshtat  
e misrit.

Prashitje, rrallim,  
prashitje, rrallim.

Parakalojnë para nesh sot  
ata që ishin të parët në këtë  
marshim.